



Fakulteti: Fakulteti i shkencave sociale

Perkujdesja dhe Mireqenja e Femiut

Moduli: Lojertat dhe Lodrat

Njesia: LOJA DHE VIZATIMI, PIKTURIMI E MODELIMI FEMIJENOR

Femijet vizatimin, pikturimin e modelimin figurativ e bejne me qellim argetimi e kureshtjeje. Pra ata lozin duke bere krijimet e tyre figurative. Kjo loje njeheresh ndikon ne rritjen e aftesive sensorike e motorikete femiut. Krijimet figurative zhvillojne aftesine e shikimi, perfytyrimin, imagjineten, perllogaritjen, perceptimin krahas rritjes se shkathtesive te duarve. Gjitashtu bene edukimin estetik te femiut qysh ne mosh parashkollore.

Vizatimi, pikturimi dhe modelimi feminor ka rendesi te pazevendesueshme per faktin se femiu perms tyre shfaqe gjendjen psikologjike, boten e tij te mbrendshme, gezimin e hidherimin, shqetesimin etj. Kjo ndodh ne moshen kur femiu nuk mund te shprehet ose ne rastet kur mbyllet ne vete dhe nuk don apo ka frike te shpreh ate qe e ndien.

Me nje fjale, vizatimi, pikturimi dhe modelimi bëjnë pjesë në format themelore të të shprehurit të personalitetit të fëmijës. Për këtë arsye vizatimet e pikturimet janë interesante jo vetëm për argëtimin dhe edukimin e fëmijëve por edhe për të njohur më mirë fëmijën dhe zhvillimin e tij të gjithanshëm.

VIZATIMI FËMIJËNOR

Fëmija në vizatim shpeshherë atë që nuk është në gjendje ta thotë me gojë ose kur është i penguar prej rrethit.

Shkallët ose fazat në për të cilat kalon vizatimi fëmijëror, sic dihet, sipas Kirsheshtainer jane: *Faza e shkarravitjes, e skematizmit dhe e trajtave e dukurive, ndërsa të njejtat faza studjuesi Like i quan Realizimi spontan, realizimi i pasuksesshëm dhe realizimi vizuel. Ndërsa disa studjes këtë ndarje e kanë bërë në: Faza e shkarravitjes, shkalla e vizatimit simbolik (skematizmit), dhe Faza e vizatimit realistik.*

Shkalla e shkarravitjes

Në fazën e shkarravitjes fëmija fillon të vizatojë në këtë mënyrë: së pari e tërheq lapsin mbi letër duke luajtur. Herë e mbanë njërën dorë, e herë në tjetrën. Fëmija sheh se lapsi dhe ngjyra lënë ngjyrëra, gjurmë. Kjo ngjallë interesim te ai. Rezultati i arrirë e nxit aktivitetin e tij në vizatim. Vijat që i tërheq fëmija mbi letër janë centripetale e centrifugale dhe kanë formën e rretheve jo të rregullt. Këto vija dhe këta rrethë jo të rregullt i quajmë shkarravitje, sepse ende nuk kane kurrefarë përmbajtje. Këto janë shprehje motorikës të fëmijës, sidomos e aktiteti të muskujve të tij. Në këtë moshë vizatimi i nevojitet fëmijës si aktivitet motorik, e jo si rezultat i vizatimit te qellimshem.

Fëmiu fillon të shkarravisë kah fundi i vitit të dytë. Mbi letër i len lëvizjet e perseritura dhe ritmike, gjë që e gëzon ate posaçërisht. Është konsatuar se fëmijët dyvjeçarë me kënaqësi të madhe ngjyrosin me brushë mbi letër. Ata dëshirojnë të vizatojnë në shoqëri, kështu që shpeshherë ngjyrosin bashkërisht mbi të njejtin letër. Te disa fëmijë ndërmjet vitit të tretë dhe të katërt fillon të shfaqet ndonjë trajtë, ndonëse fijllojnë të ngjyrosin më shpejtë. Kuptohet, edhe shkarravitja është e rëndësishme për zhvillimin e mëtutjeshëm.

Fëmijët të cilët e kanë rrokur heret në dorë lapsin, ngjyrën ose brushën, aty kah fundi i vitit të dytë, zakonisht gjatë vitit të tretë e përfundojnë fazën e shkarravitjes.

Faza e ndërmjeme ose Vizatimi i Arritur Rastësisht.

Vija e tërhequr me laps ose brushë bëhen më harmonike dhe aty – këtu fillojnë të duken shembuj figurash të cilave fëmija tani ua jep emrin.. Me këtë ai kalon në shkallën e re – në të vizatuarit simbolik.

Me të zbuluar të ndonjë ngjarshmërie ndërmjet shkarravitjes së vet dhe ndonjë objekti, vizatimit të vet, fëmiju ia vë emrin. Këtë fazë kaluese të vizatimit disa autorë e quajnë **vizatim i arritur rastësisht.**

Ruth Strang ka vërtetuar së te shumica e fëmijëve, në kushte normale, ky kalim bëhet në vitin e tretë. Në periudhën prej vitit të katërt gjer në të pestin me të drejtë mund të flasim për vizatimin e arritur me vetëdije.

Shkalla e vizatimit simbolik (Skematizmit)

Në periudhën ndërmjet vitit të tretë dhe të gjashtë, hasim në një lidhshmëri të ngushtë ndërmjet njohjes së botës nga ana e fëmijës dhe shprehjes së tij figurative. Nljohja e botës nga ana e fëmijës në këtë kohë drejtohet kah të kuptuarit e tërësisë. Fëmija shpeshherë nuk i dikton disa pjesë të veçanta, të cilat janë pjesë përbërëse esenciale të atyre tërësive, kështu që ato mungojnë shpesh në vizatimet e tij. Vizatimet e tilla të rriturit i konsiderojnë si sipërfaqësore dhe do të ishte gabim që fëmijët të kritikohen. Në këtë mënyrë ata e largojnë atë prej të shprehurit figurativ. Me vonë kur prej fëmijës së tillë kërkojnë që të vizatojnë diçka, ai do të thotë se nuk mundet.




Fig. 1 Fig. 2

Në shkallën e zhvillimit simbolik fëmija ende nuk mund t'i bashkojë drejtimit vertikale dhe horizontale në sipërfaqe, në hapësirë. Shih figurën 3, 4 dhe 5. Në këtë fazë fëmiju është ende largë paraqitjes realiste të krijimit të tij figurative. Fëmiju në këtë shkallë vizaton figura, objekte, sipas përfytyrimit të tij Edhe potë intervenohet nga të rriturit, fëmiju nuk fut në vizatim elemente që nuk bëhen pjese e këtij përfytyrimi.



Fig. 3

¹ Shkalla e vizatimit simbolik, (mosha 3 – 6 vjet). Vizatim fëmijëror që lidhë pjesët e trupit që në fakt nuk janë të tilla. Në figurë duket se si fëmiju ka vizatuar këmbët që lidhen direct me kokëne e njeriut.

² Këtu fëmiju ka vizatuar kubin. Ai nuk vizaton vetëm pjesët që janë e që sheh, por i vizaton edhe skajet ku e prek ate kur e merr për të luajtur.




Fig. 4 Fig.5

Gjatë vlerësimit të vizatimeve fëmijërore edukatorët duhet të kenë kujdes të madh sepse këto vizatime nuk paraqesin vetëm zhvillimin estetik të fëmijës por edhe botën e tyre, emocionale, psikologjike apo situatë të dhëna.




Fig. 27. — Si e vizatojnë njeriun fëmijët e moshave të ndryshme

Fig⁶

³ Vizatim fëmijëror, titulli “Familja e madhe |”

⁴ Në kohën e vizatimit simbolik fëmiju ende nuk ka ndjenjën e barazpeshës dhe të pozicioneve vërtikale dhe horizontale. Nëse e vizaton shtëpinë, drunjtë ose njeriun në kodër, këto vizatime i bën duke formuar këndin e drejtë në platform.

⁵ Menimet fëmijërore shprehen ndonjëherë edhe duke vizatuar

⁶ Si e vizatojnë njeriun, fëmijët e moshave të ndryshme

Në një rasat fëmiu e ka vizatuar shtëpinë e vetë, shtëpinë e fqinjit etj. Kur e kanë pyetur fëmiun e kujt është shtëpia që e ke ngjyrosur me ngjyrë të zezë? Ai është përgjigjur se është e fqinjit. Pastaj është pyetur: Pse e kë bërë me ngjyrë të zezë? Fëmiu ka sqaruar se ngjyrën e zeze për shtëpinë e fqinjit e ka përdorur sepse ai është i keq.

Në një rast tjetër fëmiu ka vizatuar veten dhe shumë fëmijë të tjerë. Njërin nga fëmijët e ka vizatuar shumë më të madh. Kur e kanë pyetur kush është ai.. Është përgjigjur se është ai vet. Në fakt nga gjithë grupi i fëmijëve ai ishte më i vogli. Arsyet pse e ka bërë vetem më të madh në këtë rast janë të tjera, ka dashur ta potencojë vete, ti japë rëndësi, ose të kompenzojë mungesën që ndien pse në fakt është i vogël.



Fig. 7

Kalimi në të shprehurit realistik (trajtave dhe dukurive)

⁷ Vizatimin e ka bërë një vajzë 6 vjeçare. Fëmija jeton në rrethana fatlume familjare. Nevojat emocionale të saj naë të kënaqshme dhe mosha mentale i përgjigjet noshës kalendare. Vizatimi është ngjyer me ngjyrëra të çelura dhe i tëri “është ndriçuar” nga dielli. Vazhëza e ka vizatuar shtëpinë dhe veten të maskuar për karnevale.

Kalimi nga të shprehurit simbolik të vizatimit fëmijënor në shkallën e të shprehurit realistik ndryshe është edhe **si shkallë e ndërmjetme**. Në këtë fazë fëmiju fillon të mendojë për planet, perspektivën por ende nuk e arrinë dot. Andaj planet i bënë në formë të kateve, përkatësisht në disa vija e hapësira lineare i radhitë figurat, objektet që bënë. Zakonisht faza kalimtare e realizmit kalimtar fillon në moshën 6 vjeçare dhe zgjat deri në vitin e 9-të.

Zhan Piazhe thotë se në këtë moshë, te fëmiju fillon të zhvillohet e kuptohet gradualisht e ashtuquajtura **“perspektiva e dyfishtë, sociale dhe hapsinore”**. Objektet më nuk i shikon vetëm nga këndvështrimi i vet por edhe nga këndvështrimi i të tjerëve.

Gjithashtu fillon ta kuptojë rëndësinë e krahasimit, matjes, proporcionin dhe në kuadër të saj perspektivën megjithëse ende nuk mund ta realizojë ate.

FILLIMI I TË SHPREHURIT REALISTIK (TRAJTAVE DHE DUKURIVE)

Pas vitit të 9-të, e te disa fëmijë edhe më vonë, i hasim fillet e **të vizatuarit realistik**. Fëmiju definitivisht e len të praqiturit simbolik të gjërave dhe përpiqet t’i shfaqë në mënyra të ndryshme, prej këndeve të ndryshme të të pamurit, pra, në marrëdhënje të ndrushme ndërmjet veti.

Në këtë fazë pasqyrohet angazhimi analitik i fëmisë, elementet dhe parimet figurative vinë duke u shfaqur ashtu sic janë. Porneve këtu na intesojnë më tepër fëmijët e moshës parashkollore. Në moshën e tyre ende nuk shfaqet krijimi realistik.

Në kuadër të tipit të fëmijëve sipas krijimtarisë figurative tipi grafik i fëmijëve është ai që është më afër vizatimit, sepse ky tip, sic është thënë, në krijimtarinë e tij figurative mbështetet në vijë.

PIKTURIMI FËMIJËROR

Dallimi i Ngjyrave

Dallimi i ngjyrave te fëmijët parahkollorë përparon nga viti në vit. Përparimi dallon në dy drejtime:

1. Fëmijët parahkollorë më të vegjël (**dy gjer në tri vjetësh**) deri diku **i dallojnë** me sukses **katër ngjyra (të kuqen, të verdhën, të klatërtën dhe të gjelbërtën)**.⁸
2. **Pas vitit të 5-të fëmijët arrijnë të dallojnë ngjyrat me tone.**

Duhet thënë se Fazat, ose shkallët nëpër të cilat kalon vizatimi fëmënor kalon edhe pikturimi fëmëjër.

Në fillim të punës me ngjyrë, fëmëu në fillim ate e përdor si mjet grafik, si vijë, më vonë stërvitet që ta përdor si sipërfaqe, formë.

Për zhvillimin e aftësisë së dallimit të ngjyrave, dhe ndijimin e tyre, edukatorët duhet që të organizojnë lojëra me ngjyra dhe nga këto lojëra gradualisht të kalohet në ngjyrosje të krijimeve figurative. Loja me ngjyra nuk është asgjë tjetër pos krijim artistik që buron nga bota e mbrendshme e fëmëut. Ndijimi i ngjyrave me shqisën e të pamunit dhe e ndërldhur me botën e brendshme është e njëjtë me ndijimin e tingullit muzikor me shqisën e të dëgjuarit që ndërldhet me botën e brendshme. Fëmëu që ndien ngjyrën mund të dallohet më mirë në fazën realistike të zhvillimit të tij figurativ.

Tipi i fëmëjëve që gjatë krijimtarisë së tij figurative mbështetet më tepër në ngjyrë ndryshe quhet tipi kolerik.

⁸ Për të vërtetuar këtë fëmëjës i japim ndonjë platform të ngjyrosur (ndonjë copë kartoni të ngjyrosur), ose ndonjë fije peri të ngjyrosur dhe ia vendosim ndërmjet platformave tjera të ngjyrosura, të ndryshme. Ai e kërkon platformën ose fijen e perit, e cila përka ngjyra është e njëjtë me atë që e ka përpara ose në dorë. Me rastin e eksperimentit të tillë fëmëjët arrijnë më shpejt sukses në qostë se i përdorin tonet përkatësisht ngjyrat sekundare, ngjyrën e portokallit, vjollcën si dhe tone më të shndritshme nga ngjyrat terciare dhe spektri.

MODELIMI FËMIJËNOR

Duke manipuluar me materiale të ndryshme në aktivitetin praktik, fëmija në moshën parashkollore, gjithnjë e më derjtë i percepton format në saje të shenjave të veçanta arrin gradualisht t'i njoh objektet. Ky është një process i gjatë në të cilin fëmija përparon gradualisht.

Për zhvillimin e aftësive të fëmijës si forma, volume, madhësia, perceptimi i materialeve edukatorja duhet fëmijëve tu japë lojëra me modelim, kryesisht me plastelinë dhe zallë të pastër dhe material tjera që mund të përdoren për këtë qëllim.

Zakonisht luhet lojë e bërjes së shtëpisë, figuracionit nga fauna (lepuri, bambi, zogu), flora (dekorimet me lule, me drunje...), kukullat e ndryshme... apo tema që ju intersojnë fëmijëve.



Fig⁹, 10, 11.

Tipi i fëmijëve që në krijimtarië e tyre figurative i japin rëndësi hapsirë, volumit dhe konstruksionit, që quhen tipa konstruktiv dhe hapsinor.



Fig. 10.



Fig. 11.

⁹ 10, 11, 12. Fëmijët e pëlqejnë të luajnë me plastelinë. Modelojnë ato figura prej më të ndryshmëve, por që lidhen me jetën e tyre, përshtypjet e tyre, emocionet e tyre.

